



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:098569

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05784167

**C.nr.544/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E. A. nga fshati Malishevë, komuna e Gjilanit, me ID ....., të cilën e përfaqëson me autorizim av. Burim Islami nga Gjilani, kundër të paditurve OJQ “KrudoKultura”, me seli në Gjilan, me përfaqësues ligjor E. A. nga Gjilani, rr. “Albina Syla”, nr. 125, E. A. nga Gjilani, “INSIDER” L.L.C., me seli në Prishtinë, me numër identifikues ....., e përfaqësuar nga P. O.-Drejtor Ekzekutiv, rr. “Tringë Ismajli”, nr. 40, të cilën e përfaqëson me autorizim Lekë Morina-bashkëpunëtor profesional në Zyrën e Avokatisë “Koci&Vokshi”, me seli në Prishtinë, B. K. nga Prishtina, tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme, av. Arbëra Shala nga Gjilani, për shkak të kompensimit të dëmit moral dhe material, në emër të shpifjes dhe fyerjes, vlera e kontestit 47,000.00 Euro/dyzet e shtatë mijë/, pas mbajtjes së seancës publike mbi shqyrtimin kryesor të datës 27.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia e paditëses E. A. nga fshati Malishevë, komuna e Gjilanit, me të cilën paditësja ka kërkuar që të detyrohen e paditura OJQ “KrudoKultura”, me seli në Gjilan, i padituri E. A. nga Gjilani, e paditura “INSIDER” L.L.C., me seli në Prishtinë dhe e paditura B. K. nga Prishtina, që të ndalin shpifjen dhe të premtojnë se shpifja nuk do të përsëritet në të ardhmen, si dhe të tërheqin informacionin shpifës ndaj personalitetit të paditëses E. A., duke e demantuar shpifjen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin medium të shkruar, edhe atë e paditura e parë OJQ “Krudo Kultura”, në faqen e saj dhe në rrjetin social ‘Facebook’, ndërsa e paditura “INSIDER” L.L.C., në portalin e saj zyrtar [www.insajder.org](http://www.insajder.org), edhe atë në afat prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe të detyrohen të paditurit OJQ “KrudoKultura”, me seli në Gjilan, E. A. nga Gjilani, “INSIDER” L.L.C., me seli në Prishtinë dhe B. K. nga Prishtina – gazetarë e “INSIDER” L.L.C., që paditëses E. A. nga fshati Malishevë, K. e Gjilanit, në emër të kompensimit të dëmit moral, për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit si pasojë e shpifjes së bërë përmes medimeve publike nga faqja zyrtare e OJQ “KrudoKultura” me seli në Gjilan, më dt. 15.04.2022 dhe përmes rrjetit social Facebook, si dhe nga reagimi i dt. 15.04.2022 nga përfaqësuesi i të paditurës OJQ “KrudoKultura”, E. A., nga postimi përmes rrjetit social Facebook, i dt. 15.04.2022, nga i padituri E. A., me titullin “*Djali e kunati i zyrtarës së VV-së, E. A., shpërblehen nga komuna me 7752.00 Euro*”, nga mediumi “INSIDER” L.L.C. me publikimin

e lajmit të dt. 26.03.2022, me titull “Dallaveret me fonde në Komunën e Gjilanit, zyrtarët shpërblejnë veten”, pastaj nga publikimi me titullin “Skandal: Zyrtarja e VV-së shpërblen kunatin dhe djalin e saj me mijëra euro”, i dt. 28.03.2022, i bërë nga B. K. – gazetare e “INSIDER” L.L.C., nga publikimi i shkrimit me temë “Thellohet skandali me fondet e kulturës në Gjilanin e Vetëvendosjes, Insajderi zbulon aferën e radhës”, publikuar më dt. 29.03.2022, nga B. K., si dhe nga përmbajtja e shkrimit të publikuar nga B. K., me titull “Vëllai, djali, kunati: Insajderi zbulon korrupsionin e anëtarëve të komisionit”, publikuar më dt. 29.03.2022, solidarisht t’ia paguajnë paditëses shumën prej 7,000.00 Euro/shtatëmijë/ në emër të dëmit moral si dhe në emër të dëmit material për fitimin e humbur për shkak të shpifjes dhe fyerjes, t’ia paguajnë paditëses shumën prej 40,000.00 Euro/dyzet mijë/, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, konform nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe të obligohen të paditurit që paditëses t’ia kompensojnë të gjitha shpenzimet e procedurës.

**II.** Detyrohet paditësja E.A. nga fshati Malishevë, komuna e Gjilanit, që përfaqësueses së përkohshme të caktuar nga ana e gjykatës, Av. Arbëra Shala nga Gjilani, t’ia kompensojë shpenzimet e përfaqësimit, në lartësi prej 1,019.00€, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

## **A r s y e t i m**

Paditësja E. A. nga fshati Malishevë, K. e Gjilanit, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, av. Burim Islami nga Gjilani, fillimisht në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurve OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, E. A. nga Gjilani, “Insajderi” SHPK, me seli në Prishtinë, Ardian Alaj nga Prishtina – drejtor menaxhues i “Insajderi” SHPK dhe B. K. nga Prishtina – autore e lajmit në “Insajderi” SHPK, por që gjatë fazave të mëtejme të shqyrtimit gjyqësor, paditësja ka ndryshuar padinë në aspektin subjektiv, duke u tërhequr nga pjesa e padisë që ka të bëjë me të paditurën “Insajderi” SHPK dhe të paditurin A. A. nga Prishtina – drejtor menaxhues i “Insajderi” SHPK, duke futur në vend të tyre të paditurën “INSIDER” L.L.C. dhe duke mbetur pranë të paditurve të tjerë OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, E. A. nga Gjilani dhe B. K. nga Prishtina, duke kërkuar në fund, sipas rregullimit të padisë, që të detyrohen e paditura OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, i padituri E. A. nga Gjilani, e paditura “INSIDER” L.L.C. me seli në Prishtinë dhe e paditura B. K. nga Prishtina, që të ndalin shpifjen dhe të premtojnë se shpifja nuk do të përsëritet në të ardhmen, si dhe të tërheqin informacionin shpifës ndaj personalitetit të paditëses E. A., duke e demantuar shpifjen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin medium të shkruar, edhe atë e paditura e parë OJQ “KрудоKultura”, në faqen e saj dhe në rrjetin social Facebook, ndërsa e paditura “INSIDER” L.L.C., në portalin e saj zyrtar [www.insajder.org](http://www.insajder.org), edhe atë në afat prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe të detyrohen të paditurit OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, E. A. nga Gjilani, “INSIDER” L.L.C., me seli në Prishtinë dhe B. K. nga Prishtina – gazetare e “INSIDER” L.L.C. që paditëses E. A. nga fshati Malishevë, K. e Gjilanit, në emër të kompensimit të dëmit moral për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit si pasojë e shpifjes dhe fyerjes së bërë përmes medimeve publike nga faqja zyrtare e OJQ “KрудоKultura”, më dt. 15.04.2022 dhe përmes rrjetit social Facebook, si dhe

nga reagimi i dt. 15.04.2022 nga përfaqësuesi i të paditurës “KrudoKultura”, nga postimi përmes rrjetit social Facebook, i dt. 15.04.2022 nga i padituri E. A., me titullin “*Djali e kunati i zyrtares së VV-së, E. A., shpërblehen nga komuna me 7752 Euro*”, nga mediumi “INSIDER” L.L.C., me publikimin e lajmit të dt. 26.03.2022, me titull “*Dallaveret me fonde në Komunën e Gjilanit, zyrtarët shpërblejnë veten*”, pastaj, nga publikimi me titullin “*Skandal: Zyrtarja e VV-së shpërblen kunatin dhe djalin e saj me mijëra euro*”, i dt. 28.03.2022, i bërë nga B. K. – gazetare e “INSIDER” L.L.C. nga publikimi i shkrimit me temë “*Thellohet skandali me fondet e kulturës në Gjilanin e Vetëvendosjes, Insajderi zbulon aferën e radhës*”, publikuar më dt. 29.03.2022, nga B. K., si dhe nga përmbajtja e shkrimit të publikuar nga B. K., me titull “*Vëllai, djali, kunati: Insajderi zbulon korrupsionin e anëtarëve të komisionit*”, publikuar më dt. 29.03.2022, si dhe shkrime të tjera të ngjashme të publikuara nga medime të ndryshme dhe të shpërndara në rrjetin social Facebook, kërkon që gjykata t’i detyrojë solidarisht në kompensimin e dëmit moral në shumë prej 7,000.00 Euro dhe në emër të dëmit material për fitimin e humbur, për shkak të shpifjes dhe fyerjes, t’ia paguajnë paditëses shumë prej 40,000.00 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, konform nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe të obligohen të paditurit që paditëses t’ia kompensojnë të gjitha shpenzimet e procedurës.

Lidhur me tërheqjen e padisë së paditëses ndaj të paditurve “Insajderi” SH.P.K dhe të paditurit A. A., gjykata ka marrë Aktvendim C.nr.544/2022, i datës 30.08.2023, ku ka konstatuar tërheqjen e padisë ndaj tyre.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata, konform nenit 394 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) /Ligji Nr. 03/ L-006, 30 qershor 2008/ padinë me shkresat e bashkëngjitura ia ka dërguar të paditurve, për të dhënë përgjigje në padi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë.

Meqenëse edhe përkundër shumë përpjekjeve të gjykatës për të gjetur adresën e të paditurës B. K. nga Prishtina, gjykata nuk ka arritur të gjejë vendqëndrimin e saj, ashtu që konform nenit 79 të LPK-së, të njëjtës i ka caktuar përfaqësuesen e përkohshme, avokaten Arbëra Shala nga Gjilani, në mënyrë që të mbrohen interesat e të paditurës në këtë kontest, si dhe një aktvendim të tillë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm gjykata e ka shpallur edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe me këtë konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për procedimin e mëtejme të çështjes kontestimore.

E paditura e parë OJQ “KrudoKultura”, me seli në Gjilan, themelues i së cilës është vetë i padituri E. A., nuk ka ushtruar fare përgjigje në padi, por gjatë shqyrtimeve gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë si të pabazuar në ligj, me pretendimin se faktet e paraqitura në botimin e artikujve të saj janë të vërteta, duke shtuar se këtë e dëshmon vetë anulimi i Thirrjes Publikë të datës 11.02.2022, nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, A. H..

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë “Insider” L.L.C., me seli në Prishtinë, në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë dhe ka kundërshtuar kompetencën territoriale të Gjykatës Themelore në Gjilan, pasi që konform nenit 38 të LPK-së, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në bazë

të vendbanimit të të paditurës, e meqenëse e paditura është person juridik dhe selinë e ka në Prishtinë, ka kërkuar që kjo gjykatë të shpallet jokompetente në aspektin territorial dhe lënda t'i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë të përgjithshme territoriale. Po ashtu, e paditura ka kërkuar që gjykata ta hedhë poshtë padinë si të palejueshme, pasi që sipas nenit 12 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKSHF) /Ligji nr.02/L-65 i datës 01.05.2008, GZ. nr.24/2008/ janë përcaktuar një mori kushtesh procedurale para se padia të ushtrohet në gjykatë, respektivisht neni 12 ka përcaktuar se *“Para parashtrimin të një padie sipas këtij Ligji, një person që pretendohet të jetë i dëmtuar do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkaktuar nga shprehja. Në veçanti, paditësi do të kërkojë përmirësimin e asaj shprehje nga personi i cili pretendohet të ketë shkaktuar dëmin. Veprimet e tilla mund të përfshijnë kërkesën e përmirësimit të shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese nga publikuesi dhe paraqitjen e kërkesës para organit kompetent rregullativ sikurse (Komisioni i Pavarur për Media) ose Organi vetërregullativ sikurse (Këshilli për Mediat e Shtypura)”. Kurse neni 13 i LCKSHF-së ka përcaktuar se “Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një gazetë, botim periodik, transmetim radioje ose televizioni, ose në çdo media tjetër të një natyre periodike, për të cilin ose për cilat fakte janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaroi që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person”, andaj, paditësja në rastin konkret asnjëherë nuk i është drejtuar mediumit përkatës me kërkesë për zbutjen e dëmit të pretenduar. Po ashtu, e paditura ka shtuar se me përgjegjësi të shtuar ka vepruar kur ka publikuar artikullin kontestues dhe se publikimi i deklaratës së shkruar nga e paditura e parë OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, është bërë me përgjegjësi dhe kujdes maksimal, meqë ka publikuar një deklaratë të një OJQ-je, e cila pos deklaratës ka listuar edhe provat materiale të cilat vërtetojnë faktet e pretenduara dhe se e paditura qartë ka cituar edhe burimin e informatës, ashtu që e paditura në këtë rast përjashtohet nga përgjegjësia deliktore, konform nenit 5 parag. 2 të LCKSHF-së, që numëron personat që mund të përgjigjen për shpifjen dhe fyerjen e pretenduar, si dhe faktin se publikimet dhe përmbajtja e artikujve të publikuar janë të vërteta, ngase edhe vetë Kryetari i Komunës së Gjilanit, për shkak të parregullsive, ka anuluar Thirrjen Publike të datës 11.02.2022 për Mbështetje Financiare të OJQ-ve/Individëve në Komunën e Gjilanit.*

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurës B. K., në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, meqë nuk ka prova bindëse se e paditura ka shpifur dhe fyer ndaj paditëses.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës prove veç e veç dhe të gjithave së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe në bazë të rezultatit të procedurës provuese, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditëses.

Fillimisht, gjykata konstaton se kjo gjykatë ka kompetencë territoriale për të gjykuar çështjen kontestimore, duke u bazuar në nenin 47.1 të LPK-së, meqë në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se *“Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur*

*pasoja e dëmtimit”, lidhur me nenin 55 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Në qoftë se me një padi janë paditur disa persona (neni 265 paragrafi 1 i këtij ligji), kurse për ta nuk ekziston kompetenca territoriale e së njëjtës gjykatë, kompetente është gjykata e cila është gjykatë e çështjes me kompetencë territoriale për një nga të paditurit, e në qoftë se midis tyre ka obligues kryesor dhe aksesori, gjykata që është e kompetencës territoriale për ndonjërin nga obliguesit kryesor”, që në fakt këto dispozita ligjore në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar kompetencën e zgjedhur për kërkesat e shpërblimit të dëmit, siç është rasti konkret dhe se konform nenit 55 të LPK-së, nëse për njërin nga palët ekziston kompetenca e përgjithshme territoriale, siç është rasti me të paditurën OJQ “KruDoKultura” dhe të paditurin E. A., të cilët selinë, respektivisht vendbanimin e kanë në Gjilan, atëherë edhe për të paditurit e tjerë krijohet kompetenca territoriale e përgjithshme, që në fakt nënkupton bashkëndërgjyqësi të palëve dhe në shkencë kjo tërheqje e kompetencës njihet si atraksion i kompetencës.*

### **Ligji i aplikueshëm:**

Në këtë çështje kontestimore, gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes /Ligji nr.02/L-65 i datës 01.05.2008, GZ. nr.24/2008/, meqenëse raporti juridiko-civil është krijuar pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe se i njëjti përmban dispozita ligjore që e përcaktojnë shpifjen dhe fyerjen si delikt civil dhe se dispozitat përkatëse përcaktojnë edhe kuptimin e shprehjeve shpifje dhe fyerje, mënyrën e kryerjes dhe subjektet përgjegjëse. Po ashtu, me rastin e vendosjes meritorie të çështjes, gjykata ka zbatuar edhe nenin 42 parag. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se “Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve.”, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh që “Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare” dhe në fund, gjykata ka zbatuar edhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku parashihet që “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë”, Praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

### **Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës:**

Në mes të palëve nuk janë kontestuar faktet se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjilanit, më datë 11.02.2022, kishte shpallur Thirrje Publike për Mbështetje Financiare të OJQ-ve/ Individëve, për projekte nga fusha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Gjilanit, e po ashtu, nuk është kontestuar fakti se aplikuesi sipas Thirrjes Publike të datës 11.02.2022 për Mbështetje Financiare të OJQ-ve/ Individëve, B. A., është djali i paditëses E. A., i cili ka aplikuar në këtë thirrje publike, me projektin me titull “Emigrantët” dhe aplikuesi tjetër M. A., me projektin “Dita e Çlirimit të Gjilanit”, nga OJQ “Trupa Artistike Muzikore” dhe se ai është kunati i paditëses E. A. dhe se që të dy janë vlerësuar nga anëtarët e

komisionit vlerësues, në mesin e të cilëve është edhe E. A. dhe se këta aplikues janë përzgjedhur sipas listës përfundimtare të projekt-propozimeve përfituese të OJQ-ve/Individëve, edhe atë B. A., me projektin “Emigrantët”, në shumë prej 1,200.00€, kurse OJQ “Trupa Artistike Muzikore”, me projektin “Dita e Çlirimit të Gjilanit”, në shumë prej 6,400.00€, ngase faktet e tilla i konfirmon vetë Formulari i listës përfundimtare të projekt-propozimeve përfituese të OJQ-ve/Individëve, me nr. 0031642, i datës 23.03.2022, shpallur nga DKRS e Komunës së Gjilanit, e po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se lidhur me ecurinë e këtij procesi të paditurit kanë publikuar shkrime të ndryshme, siç janë: Publikimi i dt. 26.03.2022, nga “Insajderi”, me titull “*Dallaveret me fonde në Komunën e Gjilanit, zyrtarët shpërblejnë veten*”, pastaj publikimi përmes gazetës “Nacionale”, i datës 15.04.2022, me titull “*Skandali: KrudoKultura gjen të tjera konflikte në konkursin ku zyrtarja e VV-së shpërbleu të birin*”, i shpërndarë në profilin e tij në rrjetin social Facebook nga i padituri E. A., publikimi përmes gazetës “Nacionale”, i datës 15.04.2022, me titull “*Djali e kunati i zyrtares së VV-së, E. A., shpërblehen nga Komuna e Gjilanit me 7552 Euro*”, i shpërndarë në profilin e tij në rrjetin social Facebook nga i padituri E. A., pastaj nga lajmi me titull “*Skandal: Zyrtarja e VV-së shpërblen kunatin dhe djalin e saj me mijëra euro*”, i dt. 28.03.2022, i dhënë nga B. K. – gazetare e “INSIDER” L.L.C., publikimi tjetër i gazetares B. K., me titull “*Thellohet skandali me fondet e kulturës në Gjilanin e Vetëvendosjes, Insajderi zbulon aferën e radhës*”, publikuar më dt. 29.03.2022, publikimi tjetër i gazetares B. K., me titull “*Vëllai, djali, kunati: Insajderi zbulon korrupsionin e anëtarëve të komisionit*”, publikuar më dt. 29.03.2022, publikimi nga gazeta “Nacionale”, me titull “*Një mallkim ta preu udhën*”, i dt. 27.03.2022, publikimi i datës 15.04.2022, nga “Insajderi”, me titull “*Njeriu i prapaskenës - Insajderi zbulon se si përfitoi mijëra euro personi që ndihmoi në fushatën e VV-së në Gjilan*”, publikimi nga “Prive”, me titull “*Deshi t’i japë djalit dhe kunatit fonde publike, sharkohet këngëtarja E. A.*”, publikimi nga “06 Press”, me titull “*I dhanë subvencione anëtareve të familjes, A. H. shkarkon komisionin vlerësues*”, publikimi nga “Insajderi”, i datës 15.04.2022, me titull “*Hulumtimi i Insajderit – ‘Parimet’ e A. H., afro 4 mijë euro për miqtë e partnerit të koalicionit të tij – Insajderi sjell planin e dështuar për t’iu dhënë qindra mijëra euro OJQ-ve*”, publikimi nga “Insajderi”, i datës 09.06.2022, me titull “*Konkursi i ri, përfituesit e njëjtë*”, si dhe shkrime të tjera të ngjashme të publikuara nga medime të ndryshme dhe të shpërndara në rrjetin social Facebook, ngase këto fakte konfirmohen edhe nga përmbajtja e artikujve të lartshënuar e që gjykata i ka administruar si prova materiale, por meqë janë të pohuara nga palët, në këtë aspekt gjykata nuk ka dhënë arsytetime të tjera. Po ashtu, nuk është kontestues as legjitimiteti real aktiv dhe pasiv i palëve ndërgjyqëse, ngase me publikimin e artikujve të ndryshëm nga të paditurit është krijuar raporti materialo-juridik në mes tyre, respektivisht se paditura “Insider” L.L.C., me Drejtor Ekzekutiv P. O., edhe pse fillimisht ka theksuar se ka kontest tregtar lidhur me emrin, pasi që publikimet janë bërë nga shoqëria tregtare me emrin “Insajder.org”, me seli në Prishtinë, ku si themelues ka qenë së bashku me V. K., tani ka ndryshuar emrin tregtar në “Insider” L.L.C., fakte këto që konfirmohen nga Certifikata e biznesit e lëshuar nga ARBK, ku identifikohet emri tregtar dhe numri identifikues i shoqërisë tregtare.

Kontestuese në mes palëve mbetet baza juridike e padisë, pasi që sipas paditëses, artikujt e botuar dhe publikimet e bëra nga të paditurit paraqesin shpifje dhe fyerje ndaj personalitetit të saj, me çka kanë shkaktuar dëm moral dhe material për karrierën e paditëses si këngëtare dhe si

personalitet publik, pasi që janë fakte të pavërteta, kurse sipas të paditurve publikimet nuk paraqesin shpifje dhe as fyerje, por janë fakte të vërteta dhe të gjitha shkrimet në artikujt e lartcekur kanë bazë juridike.

Gjykata, vërteton se artikujt dhe publikimi i tyre nga të paditurat OJQ “KрудоKultura”, me seli në Gjilan, me themelues të saj të paditurin E. A. dhe vetë i padituri, të dt. 15.04.2022, me titull “REAGIM”, pastaj publikimi i të paditurës “Insider” L.L.C. /atëherë Insajder/, më datë 26.03.2022, me titull “*Dallaveret me fonde ne komunën e Gjilanit zyrtaret shpërblejnë veten*”, artikulli i të paditurës B. K., i datës 28.03.2022, me titull “*Skandal: Zyrtarja e VV-së shpërblen kunatin dhe djalin e saj me mijëra euro*”, publikimi tjetër i gazetares B. K., me titull “*Thellohet skandali me fondet e kulturës në Gjilanin e Vetëvendosjes, Insajderi zbulon aferën e radhës*”, publikuar më dt. 29.03.2022, publikimi tjetër i gazetares B. K., me titull “*Vëllai, djali, kunati: Insajderi zbulon korrupsionin e anëtarëve të komisionit*”, publikuar më dt. 29.03.2022, publikimi i dt. 26.03.2022, nga “Insajderi”, me titull “*Dallaveret me fonde në Komunën e Gjilanit, zyrtarët shpërblejnë veten*”, publikimi nga “Insajderi”, i datës 15.04.2022, me titull “*Hulumtimi i Insajderit – ‘Parimet’ e A. H., afro 4 mijë euro për miqtë e partnerit të koalicionit të tij – Insajderi sjell planin e dështuar për t’iu dhënë qindra mijëra euro OJQ-ve*”, përbëjnë çështje të interesit publik, për të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ata të Komunës së Gjilanit kanë të drejtë të dinë se si po menaxhohen taksat e tyre publike dhe si po ndahen ato. Në nenin 3 pika k) të LCKSHF-së është përcaktuar se “*Çështje e interesit publik nënkupton çdo çështje e cila është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha degët e pushtetit, politikë, shëndetësi dhe siguri publike, zbatim të ligjit, administrim të drejtësisë, interes të konsumatorëve dhe interes shoqëror, ambient, çështje ekonomike, ushtrim të pushtetit, shkencë, art dhe kulturë*” dhe se këta artikujt dhe publikimet e tyre nga të paditurat, nuk paraqesin shpifje për paditësen dhe as fyerje për personalitetin e saj, ngase artikujt e botuar dhe të shpërndarë në rrjete sociale dhe medime të tjera paraqesin gjendjen reale se si ka ndodhur dhe ka ecur procesi i mbështetjes financiare sipas Thirrjes Publike të datës 11.02.2022. Faktet se artikujt e publikuar në përmbajtje janë të vërtetë dhe paraqesin gjendjen reale, gjykata i ka vërtetuar në bazë të përmbajtjes së Vendimit për emërimin e komisionit, me nr. prot. 02-158, i dt. 07.03.2022, ku në mesin e anëtarë, gjykata konstaton se është edhe paditësja E. A., e cila e ka nënshkruar procesverbalin e datës 22.03.2022, drejtuar me propozim për aprovim nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, A. H., duke i dhënë edhe listën e propozuar të OJQ-ve dhe Individëve të cilët kanë plotësuar kushtet e Thirrjes Publike, ku sipas Listës preliminare të aplikuesve, me nr. prot. 13-0030670, e dt. 21.03.2022 dhe Rezultateve përfundimtare të përfituesve, OJQ-ve dhe individëve, me nr. prot. 13 0031642, e dt. 23.03.2022, nën numrin rendor 15, është B. A., djali i paditëses dhe në numrin rendor 8 është OJQ “Trupa Artistike Muzikore”, me projektin “Dita e Çlirimit të Gjilanit”, me themelues M. A. /kunati i paditëses/, të cilët janë vlerësuar pozitivisht dhe është propozuar nga ana e komisionit vlerësues që B. A., me projektin “Emigrantet”, të përfitojë mbështetje financiare në shumë prej 1,200.00 Euro dhe OJQ “Trupa Artistike Muzikore”, me projektin “Ditë e Çlirimit të Gjilanit”, është propozuar që mbështet financiarisht me 6,400.00 Euro dhe se formularët janë nënshkruar nga anëtarët e komisionit vlerësues, në mesin e të cilëve është edhe vetë paditësja E. A.. Andaj, në një gjendje të tillë faktike, kryetari i Komunës së Gjilanit, fillimisht njofton opinionin publik për anulimin e

Thirrjes Publike, me nr. prot. 13-0016326, i dt. 11.02.2022 dhe më pastaj merr Vendim për anulimin e Thirrjes Publike, me nr. prot. 02/244, i dt. 08.04.2022, fakte këto të pakontestuara nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata rikujton se në nenin 3 të LCKSHF-së janë dhënë përkufizimet e shpifjes dhe fyerjes, ku në pikën a) përcaktohet se “*Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër. b) Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese*”, andaj, sipas kësaj dispozite ligjore, faktet e publikuara nga të paditurit nuk përbëjnë as shpifje dhe as fyerje, por paraqesin gjendjen reale të ecurisë së këtij procesi, ngase paditësja ka qenë anëtare e komisionit vlerësues lidhur me kushtet e përgjithshme të aplikuesve, ku në mesin e tyre është djali dhe kunati i saj dhe se ky propozim i është dërguar kryetarit të Komunës së Gjilanit për aprovim, por për shkak të parregullsive dhe presionit të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe atë të të paditurve, është ndërruar komisioni vlerësues, por që sërish kanë fituar kandidatët e njëjtë si në thirrjen e parë publike, e që ky fakt konfirmohet në mes tjerash nga Formulari për vlerësimin e cilësisë së aplikacioneve, për B. A., me nr. prot. 13-111/01-0046351/22, i nënshkruar nga anëtarët e komisionit N. B., L. M., K. Q., Q. A., V. R. dhe Formulari për vlerësimin e cilësisë së aplikacioneve, me nr. rendor 82, për OJQ “Trupa Artistike Muzikore”, nënshkruar nga F. I., S. R., B. D., G. M., A. M. dhe B. D..

Gjykata ka dëgjuar edhe vetë paditësen E. A., e cila në mes tjerash ka deklaruar se është e punësuar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit, si zyrtare, pra nuk është në një pozitë politike, por është përzgjedhur në bazë të një konkursi publik, si staf profesional dhe në shpalljen publike për të cilën edhe është kontesti, është emëruar si anëtare e komisionit nga kryetari i Komunës, që në fillim e ka kundërshtuar, por kur ka parë se në rast konflikti të interesit ka zëvendësues, e njëjta ka pranuar që të jetë në atë komision dhe në disa raste, jo vetëm për B. A. dhe për OJQ “Trupa Artistike Muzikore”, është zëvendësuar nga anëtari tjetër i komisionit, në mënyrë që t’i shmanget konfliktit të interesit. Tutje, ka shtuar se janë munduar të bëjnë vlerësimin ashtu siç duhet, në konsultim të vazhdueshëm me zyrën ligjore pranë zyrës së kryetarit dhe në fund kanë dalë me listën preliminare të individëve dhe OJQ-ve. Ka deklaruar se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk ndajnë mjete për kandidatët apo për OJQ-të, por këto mjete ndahen nga ana e Komunës së Gjilanit dhe nga departamentet përkatëse. Ka shtuar se pas publikimit të listës preliminare, janë ftuar nga zyra e kryetarit dhe e kanë informuar atë për punën e kryer, por që sigurisht kishte shumë pakënaqësi nga kandidatët që nuk ishin përzgjedhur dhe nga kanë filluar edhe publikimet e opinioneve të ndryshme në portale të ndryshme për punën e tyre. Duke marrë parasysh se pati shumë reagime, kryetari i Komunës vendosi që të anulohet këtë shpallje publike dhe të njëjtën ta rishpallë përsëri, me anëtarë të tjerë të komisionit, meqenëse përgjegjësia dhe autorizimet e kryetarit të Komunës ishin të qarta sa i përket mundësisë së anulimit dhe rishpalljes së shpalljes publike. Ka shtuar se po atë ditë, si komision kanë dalë me deklaratë për medie dhe kanë deklaruar për punën e kryer në mënyrë të rregullt dhe se janë të hapur për të gjithë në mënyrë që të monitorojnë zbatimin e kësaj shpallje publike. Kjo sa i përket pjesës si zyrtare për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit. Ka shtuar se të gjitha akuzat nga të tjerët, duke përfshirë edhe tani të paditurat, kanë



qenë ndaj saj si individ, si E. A. dhe si këngëtare e njohur, kurse ndaj anëtarëve të tjerë nuk ka pasur reagime.

Në fakt, sipas përmbajtjes së deklaratës së paditëses, e njëjta mohon të ketë qenë anëtare e komisionit vlerësues kur është bërë përzgjedhja e OJQ-ve dhe individëve, por që provat materiale flasin të kundërtën, siç është edhe vetë Procesverbali i datës 22.03.2022, i përpiluar nga anëtarët e komisionit vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve lidhur me Thirrjen Publike për Mbështetje Financiare, drejtuar kryetarit të Komunës Gjilanit, ku konstatohet se paditësja është nënshkruese e saj dhe e listës përfundimtare.

Si rrjedhojë e gjendjes faktike të vërtetuar si më lart dhe kualifikimin e kësaj gjendje faktike në përputhje me të drejtën materiale, kjo gjykatë erdhi në përfundim se të paditurit nuk kanë për detyrim që paditëses t'ia kompensojnë dëmin mbi bazën e shpifjes dhe fyerjes për shkak të informacionit shpifës ndaj personalitetit të paditëses në mënyrë publike, për arsye se në këtë rast rezulton se të paditurit kanë dëshmuar para gjykatës se publikimi i artikujve lidhur me ecurinë e procesit të përzgjedhjes së listës përfundimtare të OJQ-ve dhe Individëve përfitues të thirrjes publike janë të sakta dhe të vërteta dhe nuk paraqesin shpifje dhe fyerje për paditësen, ngase nuk plotësohet asnjë element nga neni 3 pika a) dhe b) të LCKSHF-së, në mënyrë që artikujt e publikuar nga të paditurit të konsiderohen nga ana e gjykatës si publikim i një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e dinë ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër apo deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese dhe nga një gjendje e tillë faktike e vërtetuar rezulton se kërkesëpadia e paditëses për vërtetimin e shpifjes dhe fyerjes është e pathemeltë në prova dhe në ligj.

Për efekt të natyrës së kësaj çështje juridike, kjo gjykatë vlerëson se ky aktgjykim është në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut e që janë të zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Kështu, Liria e Shprehjes parashihet edhe me nenin 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që citon *“se gjithkush ka të drejtën e shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë pjesë ose për të dhënë informacion ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetëror. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund ti nënshtrohen disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj, dhe që, në një shoqëri demokratike, përbejnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, për integritet territorial ose për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe për parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen të dinjitetit ose të të drejtave të njeriut, për të parandaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë pushteti gjyqësor”*. Lidhur me këtë, kjo gjykatë mban në vëmendje edhe Praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në jurisprudencën e saj, në çështjen *“Handyside kundër Britanisë së Madhe”*, ka theksuar se liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetë realizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet pozitive, ose të konsiderohen si të dëmshme apo indiferent, por edhe të tilla që fyejnë, trillojnë apo janë shqetësim për shtetin ose për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e

pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë. Për më tepër, ky aktgjykim është në përputhje të plotë edhe me nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, ku përcaktohet se “Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marr dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë” dhe me nenin 10 paragraf 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku përcaktohet se “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marr ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marr parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv”.

Gjykata ka vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore t’i bartë paditësja, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, marrë parasysh faktin se paditësja nuk ka pasur sukses në këtë kontest, ashtu që gjykata e ka detyruar paditësen E. A. nga fshati Malishevë, komuna e Gjilanit, që përfaqësueses së përkohshme të caktuar nga ana e gjykatës, av. Arbëra Shala nga Gjilani, t’ia kompensojë shpenzimet e përfaqësimit, në lartësi prej 1,019.00 Euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. Gjykata nuk ia ka njohur shpenzimet e procedurës të paditurës “Insider” L.L.C., me seli në Prishtinë, ngase e njëjta ka qenë e përfaqësuar nga bashkëpunëtori profesional, i cili nuk është avokat dhe në këto raste nuk është përcaktuar ndonjë tarifë lidhur me lartësinë e shpenzimeve. E paditura OJQ “KrudoKultura” dhe i padituri E. A. nuk i kanë specifikuar shpenzimet ashtu siç kërkon neni 463 i LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:098569, 05.06.2024**

Gjyqtari  
Berat Spahiu

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.